

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me zyrtares ligjore, Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale kundër të akuzuarit **Q. B** nga fsh. **C, K. e Gjilanit**, për shkak të veprës penale **Lidhja e Paautorizuar në Shërbime nga neni 321 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, PP. II. nr. 185/2016, të datës 28.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 20.06.2017, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 23.06.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Q. B**, nga babai **D** dhe nëna **N**, e lindur **U**, i lindur më datë ..në fsh. **C K. e Gj**, ku edhe jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, nga data e pavërtetuar, e deri më dt. 01.07.2015, në shtëpinë e tij në fsh. **C**, me dashje dhe me qëllim që vetes t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që, nga punëtorët e, është konstatuar se ka bërë lidhje direkte pa njëhsor të energjisë elektrike dhe në këtë mënyrë ka harxhuar energjinë elektrike në mënyrë të autorizuar, duke e dëmtuar distribuomi në Gj, në shumën prej 210.71 €,

-me çka ka kryer vepër penale **Lidhja e Pautorizuar në Shërbime**, nga **neni 321**, të KPRK-së, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

E G J Y K O N

M E D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarin **Q. B**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 muajsh**, dhe **Dënim Gjoke**, në shumë prej **150 (njëqindpesëdhjetë) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **15 (pesëmbëdhjetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 185/2016, të datës 28.01.2016, kundër të akuzuarit **Q. B**, për shkak të veprës penale **Lidhja e pa autorizuar në shërbime**, nga neni 321 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurorja Kujtesa Fazliu, në fund të procedurës deklaroi se me vetë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajin dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 i KPRK-se, gjendja faktike lidhur me këtë vepër penale, tani më nuk është kontestuese, prandaj bazuar ne pranimin e fajsisë dhe të provave materiale te cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim merititor sipas ligjit, i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale. Gjithashtu, i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit te merre parasysh te gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari Q. B, në fund të procedurës deklaroi se i vjen keq për veprën e kryer penale, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, premtoi se në të ardhmen nuk do ta përsëris ndonjë vepër të tillë, andaj kërkoi nga gjykata t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari Q. B e ka kryer veprën penale **Lidhja e Paautorizuar në Shërbime, nga neni 321 të KPRK-së.***

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht fajsinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa, si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 185/16, më datë 23.06.2017**

Zyrtare ligjore,
Hikmete Veliu-Pajaziti

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.